



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE NË FUSHËN E DREJTËSISË
DHE ANTIKORRUPSIONIT

DREJTORIA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE NË FUSHËN ANTIKORRUPSION
SEKTORI I PROGRAMEVE NË FUSHËN ANTIKORRUPSION

Raport konsultimi i draft raportit të monitorimit 2020, të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023

1. Titulli i draft aktit: Raporti i monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2020, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

- Konsultimi i parë (drafti 1) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, ka zgjatur 9 ditë pune (nga data 12 – 24 2 2021).
- Konsultimi në ëeb të Ministrisë së Drejtësisë, ka qenë i hapur. Publikimi është bërë në datë 12 2 2020, në menu: prioritete/strategjia ndërsektoriale në www.drejtësia.gov.al.
- Konsultimi i dytë (drafti 2) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, ka zgjatur 5 ditë pune, dhe është finalizuar me zhvillimin e takimeve të dedikuara të konsultimit (nga data 2 – 8 3 2021).

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë draft raport janë si vijon:

- Dërguar via email institucioneve përgjegjëse e zbatuese të PV SNKK dhe Departamentit në KM/ dërguar formati i raportimit për plotësim me shpjegimet dhe detajet e kërkuara. Dërguar formati i raportimit (për masa dhe indikatorë).
- Komunikimi i drejtpërdrejtë via email për çdo kontribut/raportim të marrë; kthim për plotësim informacioni, të dhënash dhe informacioni i munguar, nga data 25 - 29 1 2021.
- Tryeza konsultimi e diskutimi teknike, të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.
- Faqja zyrtare e MD-së, www.drejtësia.gov.al

Aktivitetet/takimet e realizuara janë:

- 25 janar 2021: tryezë institucionale diskutimi e konsultimi, zhvilluar online (Ministria e Drejtësisë – Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje)
- 26 janar 2021: tryezë institucionale diskutimi e konsultimi, zhvilluar online (Ministria e Drejtësisë – Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posacme)

- 29 janar 2021: tryezë institucionale diskutimi e konsultimi, zhvilluar në MD (Ministria e Drejtësisë – Policia e Shtetit)
- 8 shkurt 2021: tryezë ndërinstucionale diskutimi e konsultimi, zhvilluar në MD (Ministria e Drejtësisë – agjencite ligjzbatuese të SNKK, Policia e Shtetit, SHCBA Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posacme)
- 5 mars 2021: tryezë ndërinstucionale konsultimi, zhvilluar online (institucionet e Qasjes A – parandaluese)
- 8 mars 2021: tryezë ndërinstucionale konsultimi, zhvilluar online (institucionet e Qasjes B – ndëshkuese, Qasjes C- ndërgjegjësuere)

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit së të dhënave dhe përmbajtjes së draft raportit, u përcollën:

- nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike në stafin teknik të drejtorisë antikorrupsion rovena.pregja@drejtesia.gov.al,
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara në MD.

4. Palët e interesit të përfshira

Draft raporti është konsultuar me përfaqësues të të gjithë institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e PV SNKK dhe të grupeve të interesit në fushën antikorrupsion.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja adresuar	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Kërkohe rishikimi (plotësimi) i strukturës së raportit sipas metodologjisë së kërkuar IPSIS; Kërkohe të rivlerësohet arritja e objektivëve sipas metodologjisë IPSIS dhe kategorizimi i tyre; Kërkohe të evidentohen problematikat për secilin objektiv specifik; Kërkohe të bëhet analiza e riskut	KM	I Pranuar	Komentet dhe kërkesat për rivlerësimin dhe plotësim të raportit janë evidentuar në mënyrë korrekte në raportin përfundimtar të monitorimit. Raporti final është në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen analitike të kërkuar.

për objektika të SNKK;			
Kërkoet saktësimi i të dhënave në raport, mbi sinjalizimet në njësitë e brendshme dhe rishikim i paraqitjes grafike në draft raport	ILDKPKI	I pranuar	Është bërë plotësimi i informacionit me të dhënat dhe argumentet e sjella nga ILDKPKI
Kërkoet plotësimi i informacionit krahasues (2018-2019-2020) mbi përmbajtjen e të dhënave statistikore të përpunuara në fushën e korrupsionit	Spektori i Statistikave, MD	I pranuar	Statistikat e përmendura në pasaportën e treguesve janë deklaruar dhe pranuar të kryera, në statusin plotësisht të realizuar në raportin vjetor
Kërkoet riformulimi i vlerësimit të bërë draft raport për statutin “e parealizuar” të masave për PSH	PSH	I pranuar pjesërisht	Është përfshirë në raportin vjetor argumentimi/shpjegimi i dhënë për mosrealizimin e masës duke dhënë edhe një rekomandim për ecurinë e tij në vijim
Kërkoet korrigjimi i vlerës së treguesit në objektivin B2, për pasaktësi	PP	I pranuar	Është reflektuar korrigjimi i vlerës së kërkuar në raport